



Data: 22.02.2019

Ref.: 321/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

V E N D I M

I. Refuzohet kërkesa e Kolegji Heimerer (Nr.1487/18H, datë 31.10.2018) për riakreditim/akreditim të programeve të studimit si më poshtë:

- Shkencat Shëndetësore për Profile Terapeutike, BSc, 180 ECTS (me specializime: Logopedi, Ergoterapi, Fizioterapi);
- Shkencat Shëndetësore për Profile Diagnostike, BSc, 180 ECTS, (me specializim: Teknik Laboratori);
- Pedagogjia Profesionale në Shëndetësi/Fusha Profesionale Infermieri, BSc, 180 ECTS;
- Infermieri Intensive, MSc, 120 ECTS, dhe
- Audiologji, MA Profesional, 120 ECTS.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Kolegji Heimerer ka parashtruar kërkesë (Nr.1487/18H, datë 31.10.2018) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për riakreditim dhe akreditim të programeve të studimit si në vijim: Shkencat Shëndetësore për Profile Terapeutike, BSc, 180 ECTS (me specializime: Logopedi, Ergoterapi, Fizioterapi); Shkencat Shëndetësore për Profile Diagnostike, BSc, 180 ECTS, (me specializim: Teknik Laboratori); Pedagogjia Profesionale në Shëndetësi/Fusha Profesionale Infermieri, BSc, 180 ECTS; Infermieri Intensive, MSc, 120 ECTS; Audiologji, MA Profesional, 120 ECTS; Infermieri, BSc, 180 ECTS; Menaxhimi i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore, MSc, 120 ECTS, dhe Psikologji Vlerësimi dhe Intervenimi MA Profesional, 120 ECTS.

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KShC në mbledhjen e mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019 ka trajtuar aplikacionin e Kolegji Heimerer. Në pikën 1.2 të nenit 10 të UA për Akreditim, thuhet, *“Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së”*.

Mbi këtë bazë, KShC erdhi në përfundim se programet e studimit Shkencat Shëndetësore për Profile Terapeutike, BSc, 180 ECTS (me specializime: Logopedi, Ergoterapi, Fiziooterapi); Shkencat Shëndetësore për Profile Diagnostike, BSc, 180 ECTS, (me specializim: Teknik Laboratori); Pedagogjia Profesionale në Shëndetësi/Fusha Profesionale Infermieri, BSc, 180 ECTS; Infermieri Intensive, MSc, 120 ECTS, dhe Audiologji, MA Profesional, 120 ECTS, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për aprovim të aplikacionit.

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*.

Sipas nenit 26, pika 5.3.11 e UA për Akreditim, *“Programet e studimit me mungesë të stafit akademik me gradën Dr.sc., ashtu siç është paraparë më këtë UA, (Infermieri BSc, Mami, BSc dhe Gjuha e Shenjave BSc), do të lejohen të hyjnë në procedurë të vlerësimit dhe akreditimit, me kusht që institucioni i arsimit të lartë do të siguron AKA-në që ka marrëveshje të bashkëpunimit me të paktën një institucion ndërkombëtar të arsimit të lartë i cili në vendin e tij të origjinës është i akredituar”*.

Bazuar në nenin e referuar më sipër KShC ka verifikuar te gjithë dokumentacionin relevant të kualifikimit të stafit akademik për programet e studimit. Këto të dhëna janë prezantuar në mbledhjen e KSHC-së të mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019, dhe pas shqyrtimit të dosjes për secilin staf akademik, KShC mori vendim që të refuzoj aprovimin e aplikacioneve të Kolegjit Heimerer, sipas pikës një të dispozitivit të këtij vendimi.

1. **Për programin e studimit: Shkencat Shëndetësore për Profile Terapeutike, BSc, 180 ECTS (me specializime: Logopedi, Ergoterapi, Fiziooterapi),** si bartës të këtij programi Kolegji Heimerer ka paraparë këta persona: Muljaim Kacka; Sadik Llullaku, Laura Pajaziti, Dianna Ullrich, dhe Bujar Shabani.

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*.

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji Heimerer, duhet të ketë të paktën tre anëtar të stafit akademik me gradën shkencore *PhD* me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky institucion për këtë program të studimit, u konstatua që tre nga katër bartësit të prezantuar më sipër në programin, *Shkencat Shëndetësore për Profile Terapeutike, BSc, 180 ECTS (me specializime: Logopedi, Ergoterapi, Fizioterapi)*, nuk i përmbushin kriteret ligjore për të qenë bartës të këtij programi. Muljaim Kacka është *PhD* në Shkenca Sociale, në fushën e Logopedisë, Sadik Llullaku, *PhD* në Shkencat e Mjekësisë, Laura Pajaziti, *PhD* në Studime të thelluara të aspekteve epidemiologjike, diagnostike dhe terapeutike të sëmundjeve të lëkurës, dhe Bujar Shabani, *PhD* në Biomekanikë.

Nga ajo çka u tha me lartë, konfirmohet se vetëm Muljaim Kacka është i fushës së programit të studimit. Ndërsa Sadik Llullaku, *PhD* në Shkencat e Mjekësisë, Laura Pajaziti, *PhD* në Studime të thelluara të aspekteve epidemiologjike, diagnostike dhe terapeutike të sëmundjeve të lëkurës, dhe Bujar Shabani, *PhD* në Biomekanikë, nuk i përkasin fushës së programit të studimit, ashtu siç është përcaktuar me nenin 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim. Ndërsa Dianna Ullrich nuk ka nostrifikim të diplomës nga MASHT, ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore në fuqi. Sipas Udhëzimit Administrativ 16/2016 për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, neni 3, pika 1,5 dhe 6, thuhet që: “për qellim të punësimit, këto diploma duhet të nostifikohen nga MASHT”. Mbi këtë bazë në mungesë të vendimit për nostrifikim të diplomës (nga MASHT, siç parashihet me këtë UA), të studimeve të doktoratës, i njëjti nuk plotëson kushtet ligjore për të qenë bartës i këtij programi të studimit.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, dhe në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, KSHC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, *Shkencat Shëndetësore për Profile Terapeutike, BSc, 180 ECTS (me specializime: Logopedi, Ergoterapi, Fizioterapi)*.

2. Për programin e studimit: *Shkencat Shëndetësore për Profile Diagnostike, BSc, 180 ECTS, (me specializim: Teknik Laboratori)*, si bartës të këtij programi Kolegji Heimerer ka paraparë këta persona: Valon Morina (*PhD* në Biologji), Bukurie Zhubi (*PhD* në Shkencat e Mjekësisë), Arber Neziri (*PhD* në Sëmundjet Kirurgjikale), dhe Iliriana Alloqi Tahirbegolli (N).

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: “Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull *PhD* nga fusha e programit të studimit”.

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji Biznesi, duhet te ketë te paktën tre anëtar të stafit akademik me gradën shkencore *PhD* me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky institucion për këtë program të studimit, u konstatua që tre nga katër bartësit e prezantuar më sipër në programin, *Shkencat Shëndetësore për Profile Diagnostike, BSc, 180 ECTS, (me specializim: Teknik Laboratori)*, nuk i përmbushin kriteret ligjore për të qenë bartës të këtij programi.

Nga ajo çka u tha me lartë, konfirmohet se vetëm Valon Morina (PhD në Biologji), mund te jetë bartës i këtij programi. Ndërsa, Bukurie Zhubi (PhD në Shkencat e Mjekësisë) dhe Arber Neziri, PhD në Sëmundjet Kirurgjikale, nuk i përkasin fushës së programit të studimit, ashtu siç është përcaktuar me nenin 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim. Ndërkaq, Iliriana Alloqi Tahirbegolli nuk ka nostrifikim të diplomës nga MASHT, ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore në fuqi. Sipas Udhëzimit Administrativ 16/2016 për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, neni 3, pika 1,5 dhe 6, thuhet që: *“për qellim të punësimit, këto diploma duhet të nostrifikohen nga MASHT”*. Mbi këtë bazë në mungesë të vendimit për nostrifikim të diplomës (nga MASHT, siç parashihet me këtë UA), të studimeve te doktoratës, i njëjti nuk plotëson kushtet ligjore për të qenë bartës i këtij programi të studimit.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore te sqaruara me lartë, në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në nenin 26, pika 5.3.4 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, KSHC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, *Shkencat Shëndetësore për Profile Diagnostike, BSc, 180 ECTS, (me specializim: Teknik Laboratori)*.

3. Për programin e studimit: *Pedagogjia Profesionale në Shëndetësi/Fusha Profesionale Infermieri, BSc, 180 ECTS*, si bartës të këtij programi Kolegji Heimerer ka paraparë këta persona: Bernard Tahirbegolli (PhD në Shendetin Publik), Gazmend Bojaj (PhD në Shendetin Publik), Ferat Sallahu (PhD në Shkencat e Mjekësisë).

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë te paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*.

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji Heimerer, duhet te ketë te paktën tre staf akademik me gradën shkencore *PhD* me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky institucion për këtë program të studimit, u konstatua që tre bartësit e prezantuar më sipër në programin, *Pedagogjia Profesionale në Shëndetësi/Fusha Profesionale Infermieri, BSc, 180 ECTS*, nuk i përmbushin kriteret ligjore për të qenë bartës i këtij programi. Bernard Tahirbegolli është PhD në Shëndetin Publik, Gazmend Bojaj është PhD në Shëndetin Publik, Ferat Sallahu, PhD në Shkencat e Mjekësisë, nuk i përkasin fushës së programit të studimit (didaktikë dhe infermieri), ashtu siç është përcaktuar me nenin 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, dhe në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në nenin 26, pika 5.3.4, e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, KSHC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, pasi që asnjëri nga bartësit e këtij programi të studimit nuk i përkasin fushës *Pedagogjia Profesionale në Shëndetësi/Fusha Profesionale Infermieri*.

4. **Për programin e studimit:** *Infermieri Intensive, MSc, 120 ECTS*, si bartës të këtij programi Kolegji Heimerer ka paraparë këta persona: Vlora Aliu (MA Menaxhment Shëndetësor), Shpresa Neziri (MA Menaxhimi i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore), Albina Bytyqi (MA Menaxhimi i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore).

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*.

Ky program ka 120 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji Heimerer, duhet të ketë të paktën dy staf akademik me gradën shkencore *PhD* me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky institucion për këtë program të studimit, u konstatua që asnjëri nga bartësit e propozuar të programit nuk ka gradën shkencore *PhD* të fushës së infermierisë. Andaj bazuar mbi këtë bazë, dhe në mungesë të stafit akademik me gradën shkencore *PhD* siç parashihet me nenin 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, KSHC erdhi në përfundim se ky program nuk i përmbushë kriteret ligjore për aprovim, andaj vendosi për refuzim si në dispozitiv të këtij vendimi.

5. **Për programin e studimit:** *Audiologji, MA Profesional, 120 ECTS*, si bartës të këtij programi Kolegji Heimerer ka paraparë këta persona: Dugagjin Spanca, Aziz Mustafa.
- Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018): *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*.


Ky program ka 120 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji Heimerer, duhet të ketë të paktën dy anëtar të stafit akademik me gradën shkencore *PhD* me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky institucion për këtë program të studimit, u konstatua që asnjëri nga bartësit e programit nuk ka gradën shkencore *PhD*. Dugagjin Spanca është Doktor i Mjekësisë, ndërsa Aziz Mustafa MA në Shkencat e Mjekësisë. Andaj bazuar mbi këtë bazë, dhe në mungesë të stafit akademik me gradën shkencore *PhD* siç parashihet me nenin 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, KShC erdhi në përfundim se ky program nuk i përmbushin kriteret ligjore për aprovim, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Heimerer";
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

